

V E N D I M
Nr.48, datë 30.7.1999

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë e përbërë nga :

Fehmi Abdiu,	yetar i Gjykatës Kushtetuese
Hilmi Dakli,	Anëtar i “ ”
Hajredin Fuga,	Anëtar i “““
Zija Vuci,	Anëtar i “““
Alfred Karamuço,	Anëtar i “““
Kristofor Peçi,	Anëtar i “““
Kujtim Puto,	Anëtar i “““
Sokol Sadushi,	Anëtar i “““

Me sekretare Arbenka Lalica, më datë 14.7.1999, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura kërkesën me nr.50 Akti që i përket :

KËRKUES: RAMIZ LALA

SUBJEKT I INTERESUAR: KËSHILLI I LARTË I DREJTËSISË, i përfaqësuar nga zoti Kudret Kopo.

OBJEKTI:

Shfuqizimi si antikushtetues i Vendimit nr.1391, datë 2.12.1998 të Gjykatës së Kasacionit.

Kërkuesi pretendon se vendimi i Gjykatës së Lartë i ka cënuar të drejtat e tij kushtetuese nga zhvillimi i një procesi të parregullt ligjor, duke arsyetuar se:

- Gjykata e Lartë nuk ka respektuar kërkesat procedurale që kanë të bëjnë me parimin e kontradiktoritetit, me të drejtën për t'i dhënë shpjegime të plota për çështjen si dhe me mënyrën e pranimit dhe të vlerësimit të provave në gjykim;

- Gjykata e Lartë është treguar e njëanshme në marrjen e vendimit, pasi ka vlerësuar vetëm shpjegimet e të dhënave të sjella nga pala kundërshtare dhe nuk ka përmendur provat dhe arsyet në të cilat është mbështetur, por ka nxjerrë përfundime të pashqyrtuara as nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe as nga vetë Gjykata;

- Në përbërje të trupit gjykues në Kolegje të Bashkuara kanë marrë pjesë gjyqtarë të cilët janë anëtarë të Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe që janë shprehur më parë për këtë çështje.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi shpjegimet e kërkuesit, përfaqësuesit të subjektit të interesuar dhe e bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Kërkuesi Ramiz Lala, është larguar nga detyra e kryetarit të Gjykatës së Rrethit Kukës, si dhe nga detyra e gjyqtarit me vendimin nr.17, datë 11.7.1998 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, “për shkelje të rëndë të disiplinës në punë”.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë me vendimin nr.1391, datë 2.12.1998 kanë rrëzuar kërkesën, duke lënë të pacënuar vendimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Gjykata Kushtetuese, konstaton se shqyrtimi gjyqësor i kësaj çështjeje në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë është rrjedhojë e një procesi ligjor të parregullt, që konsiston në cënimin e parimit kushtetues të paanshmërisë së gjykatës.

Gjatë shqyrtimit të çështjes në Kolegjet e Bashkuara në përbërje të trupit gjykues kanë marrë pjesë dhe dy anëtarë të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, të cilët lidhur me personin konkret janë shprehur dhe kanë dhënë mendimin e tyre, duke votuar më parë në këtë organ. Pikërisht, pjesëmarrja si gjyqtarë e dy anëtarëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë në gjykimin e çështjes në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, pavarësisht nga ndikimi i prezencës dhe i mendimit të tyre në të gjithë trupin gjykues, është një arsye e mjaftueshme dhe njëkohësisht një garanci më pak për kërkuesin, tek i cili është krijuar dyshimi i bazuar, se gjykata nuk ka qenë e paanshme në shqyrtimin e kësaj çështjeje.

Fakti që dy gjyqtarë të Kolegjeve të Bashkuara marrin pjesë në shqyrtimin e një çështjeje gjyqësore, ku palë ndërgjyqëse është institucioni apo organi, anëtarë të të cilit ata janë zgjedhur, është një shkak i arsyeshëm, që nuk e mënjanon dyshimin tek kërkuesi, që në rastin konkret objektivist ekziston.

Mosrespektimi i parimit kushtetues të zhvillimit të një procesi gjyqësor nga një gjykatë e paanshme, i sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe në nenin 6 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, përbën cënim të procesit të rregullt ligjor dhe për rrjedhojë sjell shfuqizimin si antikushtetues të vendimit të Kolegjeve të Bashkuara.

Të njëjtin qëndrim të argumentuar teorik dhe ligjor ka mbajtur Gjykata Kushtetuese edhe në vendimin nr.43, datë 4.6.1999, lidhur me parimin e paanshmërisë së gjykatës në shqyrtimin e çështjeve.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 132 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe nenit 41 të Ligjit nr.8373, datë 15.7.1998 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri

V E N D O S I:

Shfuqizimin si antikushtetues të Vendimit nr.1391, datë 2.12.1998 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Tiranë, më 30.7.1999

Nr. 50 i Regjistrimit themeltar

Nr. 48 i Vendimit.